



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC  
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 92

Më:13/04/2018

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokolli 168 i dt.30/03/2018 lidhur me organizimin e ekskursionit për maurantë në Shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Shkodër, Krujë, Tiranë, Fieri, Vlorë dhe Berat. Ekskursioni zgjat 5 bujtje (pansion i plotë) prej datës 26/04/2018 deri me 01/05/2018.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maurantëve të Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë:

1. “Meti – Comerc - H” me çmim 100.00 €;
2. N.T.SH “ Mendi ” me çmim 115.00 €;
3. N.P.SH “Ylli ” me çmim 118.00 €;
4. N.P.T “Bledi” me çmim 100.00€;

**Raport i Komisionit selektues:**

Hapja e ofertave u bë me dt.10/04/2017 në ora 14:00 sipas ofertës nr.1099 i dt.20/04/2017 ku prezent ka qenë përfaqësueset e Drejtorisë së Arsimit znj.Flutur Këpuska, znj.Gjyljeta Dula Përfaqësueset e Këshillit Drejtues të Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë, znj.Merita Bokshi – Drejtoreshë e Shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë, z.Menduh Hasani i ftuar në cilësi të procesmbajtësit të shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë, z.Dardan Bakija – Zyrtar ligjor i ftuar në cilësi të vëzhguesit si dhe përfaqësuesit e kompanive konkurruese.

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

**Firma transportuese “Meti – Comerc – H”** ka konkuruar me çmim prej 100.00€, sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë iu është ofruar qëndrim në hotelet “Ballkan” që gjendet afër shkëmbit të Kavajës, “Elba”, dhe “Kaloverti Resort”, në ofertë përfshin që mësimdhënësit (kujdestarët e klasave) do të jenë pa pagesë, po ashtu në ofertë të përfshihen pesë (5) bujtje me pansion të plotë që nga dt.26/04/2018 gjer me dt.01/05/2018. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë

Kosovës, licenë kjo e vlefshme nga dt.24/04/2014 gjer me dt.23/04/2019. Posedon Certifikatën e Mjekut dr.Ilir Grezda ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese “Meti – Comerc – H” për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë. Janë të përfshirë 4 shoferë e të pajisur me certifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 4 autobusë.

**Firma transportuese N.T.SH “Mendi”** ka konkuruar me çmim prej 115 €, për Drejtorinë e Shkollës dhe Kujdestarët e klasave iu është ofruar shërbime gratis. Oferta bazohet në 5 (pesë) bujtje me pansion të plotë, iu është ofruar qëndrim në Hotel “Skampa” në Durrës, ndërsa vizita qyteteve të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese. Janë të përfshirë tre (3) shoferë e të pajisur me certifikatë mjekësore dhe janë prezantuar 3 autobusë. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licenë kjo e vlefshme nga dt.21/12/2015 gjer me dt.20/12/2020. Ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatën – Deklarues i TVSH-ës.

Tek dosja e patent shoferit z.Demë Lajçi është përfshirë edhe oferta për Agjensionin Turistike “Bledi” për shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë por e njëjta nuk është e nënshkruar nga vet menaxheri i N.P.T “Bledi” ashtu që Komisioni selektiv nuk e merr parasysh ofertën e tillë, pasi edhe vet ky agjension nuk ka aplikuar fare në këtë tender nga shkolla “Kadri Kusari” në Gjakovë. I njëjti nuk ka prezantuar përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit ashtu siç kërkohet edhe me tenderin me numër protokolli 168 i dt.30/03/2018.

**Firma transportuese N.P.SH “Ylli”** ka konkuruar me çmim prej 118.00 €, është ofruar qëndrim në Hotel “Elba” në Durrës, me pesë (5) bujtje dhe pansion i plotë i ushqimit, ndërsa mjekun ka shënuar që mund të sigurohet pas konfirmimit të ofertës. Në ofertë ka përfshirë që vizita e qyteteve tjera dhe instituteve të ndryshme, realizohet në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të Shkollës. Hyrjet në institucione (muze apo ndonjë institucion tjetër) nuk janë të përfshirë në ofertë. Posedon Licencë C – Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të rregullt të udhëtarëve me autobus dhe transport të lirë brenda Kosovës, licencë kjo e vlefshme prej dt.21.10.2014 gjer me 20.10.2019. Ka prezantuar Certifikatën e regjistrimit, Certifikatën e numrit fiskal. Ka prezantuar 4 autobusë, janë të përfshirë 3 shoferë, njëri prej tyre e ka certifikatën mjekësore, dy të tjerë nuk janë të prezantuar certifikata mjekësore si dhe z.Basri Hadri ka patent shofer të shtetit të Austrisë.

**Firma transportuese NPT “Bledi”** ka konkuruar me çmim prej 100.00€ ku për ofrimin e gjithë këtyre shërbimeve është përfshirë transporti dhe hoteli, ndërsa për ofrimin e të gjitha shërbimeve çmimi për nxënës është 110.00€ ku përfshihet transporti, hoteli si dhe pagesat në institucionet kulturore historike që shkolla do t’i dërgojë sipas agjendës. Ka prezantuar Licencën e Punës Dr.Atdhe Aziz Agaj së bashku me kontratën e punës të kontraktuar nga kompania “Bledi” për kryerjen e shërbimeve mjekësore për nxënësit (maturantët). Ka prezantuar konfirmim rezervimi nga administratori Astrit Ismaili të Hotel Bonita. Ka prezantuar Licencë nga Qendra Kombëtare e Licencimit – Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë me datë të lëshimit 04/11/2013. Ka prezantuar 4 shoferë me certifikata mjekësore të tyre dhe 4 autobusë. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licenë kjo e vlefshme nga dt.13/01/2016 gjer me

dt.12/01/2021. Ka prezantuar Certifikatën – Deklarues i TVSH-së, Certifikatën e Numrit Fiskal, Certifikatën e Regjistrimit. Ka prezantuar kontrata të ndryshme të shërbimit si dhe referencat të lëshuara nga institucionet e ndryshme, si dhe ka prezantuar edhe me foto kompleksin Bonita.

#### **Vlerësimi i Komisionit selektues:**

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç'rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, ku komisioni selektues me dt.12.04.2018 (e enjte) iu janë prezantuar Pëlqimet e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (10 mësimdhënës).

Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë të përzgjedhet firma N.P.T “Bledi” me çmim prej 100.00€

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike **N.P.T “Bledi”**

Menaxher z.Albrim Jaha

Nga Gjakova

#### **Arsyetim**


Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasëve të 12-ta (10 arsimtarë), Pëlqimit të Këshillit të Prindërve për secilën klasë veç e veç (për 10 klasë), listave për aprovimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e të gjithë nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë të përzgjedhet firma **N.P.T “Bledi” me çmim prej 100.00€**, gjithashtu hoteli i prezantuar nga agjensia turistike ofron siguri të mjaftueshme që të mos ketë hyrje dhe dalje nga persona të pa autorizuar (rrethoja) të paraparë sipas pikës 5 të tenderit me numër të protokollit 168 i dt.30/03/2018 të shkollës “Kadri Kusari” në Gjakovë. Komisioni i vizitës me dt.11/04/2018 (e mërkurë) me përbërje të Këshillit Drejtues të Shkollës (prind, profesor dhe nxënës) kanë vizituar të gjitha hotelet e prezantuara nga agjensitë konkurruese, ku kanë vizituar kushtet të cilat ofrohen nga hotelet në fjalë, ku të njëjtit kanë kërkuar licencën e akreditimit të ushqimeve dhe nga hotelet në fjalë ka prezantuar para Komisionit vetëm Hotel “Bonita” të parapara sipas pikës 8 të Tenderit me numër të protokollit 168 i dt.30/03/2018.

Komisioni selektues:

1. Flutur Këpuska  
(emri dhe mbiemri)

  
(pozita) dt.13/04/2018

2. Gjyljeta Dula  
(emri dhe mbiemri)

  
(pozita) dt.13/04/2018

3. Merita Bokshi  
(emri dhe mbiemri)

  
(pozita) dt.13/04/2018

**Këshilla juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Agjencie turistike
- Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë
- Shërbimit juridik
- Arkivit